



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 78/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në vendet publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

VENDIM

LEJOHET tërheqja e ankesës e Institutit Demokratik të Kosovës-KDI, Anr. 78/2017 e datës 05.06.2017.

Arsyetim

Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) ka paraqitur ankesë në PZAP kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në vendet publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pasi që ankesa ka qene e paqarte, PZAP-i ka kërkuar nga parashtruesi i ankese që të bëjë plotësimin e ankesës.

Me datë 06.06.2017 ankuesi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesë me numër:Anr.78/2017, duke u bazuar në faktin se KDI nuk ka prova shtesë për ti ofruar PZAP-it.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 78/2017 më datën 07.06.2017.

